

PROCESVERBAL – Tipi i kontratës-PUNË

PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE KRITEREVE PËR KUALIFIKIM

OBJEKTI I PROKURIMIT: Rikonstruksion rruga “Bregu i Detit” Velipojë

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT Kodi (CPV):
45210000-2 - Punime ndërtimi

VLERA E FONDIT LIMIT: 57,123,333(Pesedhjetë e shtatë milion e njëqind e njëzet e tre mijë e treqind e tridhjetë e tre)lekë pa tvsh.

Në bazë të nenit 21, pika 2, të ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, autoriteti/enti kontraktor Bashkia Shkodër ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

- a. Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8
- b. Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP, dhe nenin 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen me Nenin 76 “Kriteret detyruese për skualifikim” Nenin 82 “Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit” dhe Neni 83 “Sigurimi i ofertes”, të Ligjit Nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik” si dhe në mbështetje të Nenit 26 “Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit” dhe nenit 30, pika 1, të VKM-së nr.285, datë 19.5.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik:

Neni 82, i LPP “1. Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoritetet ose entet kontraktore pranojnë si prova paraprake në vend të disa vertetimeve të leshuara nga autoritetet publike ose pale të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas parashikimeve të këtij ligji. Përmbajtja e këtij formulari përcaktohet në rregullat e prokurimit publik”.

Neni 83 i LPP “Autoriteti kontraktor duhet të kërkojë paraqitjen e sigurimit të ofertës nga ofertuesit në të gjitha llojet e procedurave të prokurimit, me përjashtim të procedurave të prokurimit me vlerë të vogël”,

2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

2.1. Përshtatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale (nëse është e aplikueshme):

Me paraqitjen e Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit të operatorit ekonomik sipas Shtojcës 8.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/a dhe 2, të LPP, nenin 39, pika 6/b, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” si dhe ne Ligjin Nr.9723 datë 03.05.2007 “Për Qendrën Kombëtare të Biznesit”, te ndryshuar.

2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1 Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare **2022-2023-2024**, ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se vlera e përlogaritur e kontratës që prokurohet dhe konkretisht **57,123,333** (Pesdhjete e shtate milion e njeqind e njezet e tre mijë e treqind e tridhjetë e tre) lekë.

Kriteri konsiderohet i përmbushuar nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën 1(një) vit të periudhës së kërkuar të viteve financiare.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë:

Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 pika 3 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, *”Ne lidhje me situatën ekonomike dhe financiare, autoritetit ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë që operatorët ekonomikë kanë kapacitetin e nevojshëm ekonomik dhe financiar për të zbatuar kontratën”, “Xhiroja vjetore minimale që kërkohet nga operatorët ekonomikë nuk mund të tejkalojë dyfishin e vlerës së parashikuar të kontratës”,* si dhe bazuar në nenin 43, pika 2/b, nenin 55 pika 4 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” *Vlera e xhiros minimale vjetore që u kërkohet operatorëve ekonomikë nuk mund të tejkalojë: c) vlerën e parashikuar të kontratës, në procedurat e prokurimit ndërmjet kufirit të lartë dhe të ulët monetar.*

Vendosja e këtij kriteri kualifikues i shërben Autoritetit Kontraktor për të vërtetuar se operatori ekonomik fitues i zoteron të gjitha kapacitetet ekonomike dhe financiare për të përmbushur me sukses kontratën.

Duke marrë në konsiderate vlerën e fondit limit të kesaj procedure prokurimi, kërkohet që OE ofertues të paraqesë se disponon kapacitetet e nevojshme ekonomike dhe financiare për ta realizuar atë në kohë dhe në përputhje me specifikimet teknike të kërkuara. Për këtë, OE ofertues duhet të ketë disponibilitetin e duhur ekonomik dhe me këtë qëllim, është argumentuar se vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se **57,123,332** (Pesëdhjetë e shtatë milion e njëqind e njëzet e tre mijë e treqind e tridhjetë e dy) lekë që është sa vlera e fondit limit dhe vendosja e këtij limiti nuk kufizon pjesëmarrjen e operatoreve ekonomike.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë në zbatim të ligjit Nr. 29/2023 “Për tatimin mbi të ardhurat” i ndryshuar, Udhëzimit të Ministrit të Financave Nr.5, datë 30.01.2006, “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar, VKM-së Nr. 922 datë 29.12.2014 “Për deklarimin e detyrueshëm të deklaratave tatimore dhe të dokumenteve të tjera tatimore, vetëm nëpërmjet formës elektronike”, si dhe kërkesave të Ligjit Nr. 25/2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”.

AK në miratimin e këtij kriteri ka mbajtur në vëmendje nenin 61 të ligjit Nr. 29/2023 “Për tatimin mbi të ardhurat” i ndryshuar: “Deklarata tatimore vjetore dorëzohet në organin tatimor jo më vonë se data 31 mars e vitit pasardhës të vitit tatimor për të cilin dorëzohet deklarata” si dhe Akt Ekspertizën e Ekspertit Kontabël të Autorizuar në rastet kur plotësohen kushtet e parashikuara nga ligji.

2.2.2. Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë kopje të certifikuara të bilanceve të viteve **2022-2023-2024** të paraqitura në Administratën Tatimore dhe të konfirmuara prej tyre, të shoqëruara me Akt Ekspertizën e Ekspertit Kontabel të Autorizuar, në rastin kur janë në kushtet e përcaktimeve nën 41, pika ”c”, të Ligjit nr. 10091, datë 5.03.2009 “Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të audituesit ligjor dhe të kontabilistit të miratuar”, i ndryshuar. Në zbatim të nenit 43, pika 4, të VKM nr.285, datë 19.05.2021, kjo kërkesë konsiderohet e përmbushur nëse në dy bilance të njëpasnjëshme, nuk ka raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenit 43, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e bilanceve është bërë duke iu referuar legjislacionit të fushës, konkretisht, ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, Udhëzimit të Ministrit të Financave nr.5, datë 30.01.2006, "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, si dhe kërkesave të ligjit Nr. 25/2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”. Referuar në nenin 29 të Ligjit Nr. 8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat tatimore: “Çdo tatimpagues përgatit deklaratën vjetore të të ardhurave të tatueshme në formën e përcaktuar në udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të këtij ligji. Tatimpaguesit paraqesin deklaratën vjetore në organet tatimore brenda datës 31 mars të vitit pasardhës, duke paraqitur në të njëjtën kohë bilancin kontabël, së bashku me anekset e tij, si

dhe çdo të dhëne tjetër të përcaktuar në udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të këtij ligji.

Akt Ekspertiza e Ekspertit Kontabël të Autorizuar, duhet të paraqitet nga OE vetëm në rastin kur janë në kushtet e përcaktimeve të nenit 41, gërma “c” të Ligjit nr. 10091, datë 05.03.2009 “Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të ekspertit kontabël të regjistruar dhe të kontabilistit të miratuar”, i ndryshuar, ku parashikohet se: “Personat juridikë që detyrohen për auditimin ligjor të pasqyrave financiare detyrohen të kryejnë auditimin ligjor të pasqyrave financiare vjetore, përpara publikimit të tyre, nga eksperte kontabël ose shoqëri audituese: "c) shoqëritë me përgjegjësi të kufizuar, të cilat zbatojnë për raportimin financiar standardet kombëtare të kontabilitetit, kur, në mbyllje të periudhës kontabël, **për dy vite radhazi, tejkalojnë dy prej tre treguesve të mëposhtëm:** i) totali i aktiveve të bilancit, në mbyllje të periudhës kontabël përkatëse, arrin ose e kalon shumën prej 50 milionë lekësh; ii) shuma e të ardhurave nga veprimtaria ekonomike (qarkullimi) në atë periudhë kontabël arrin ose e kalon shumën prej 100 milionë lekësh; iii) ka, mesatarisht, 30 të punësuar gjatë periudhës kontabël”.

2.2.3 Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë një dokument që vërteton se ka paguar të gjitha detyrimet e taksave dhe tarifave vendore lëshuar nga Administrata e Qeverisjes Vendore për të gjitha vendet ku operatori ushtron aktivitetet për vitin 2025 (Sipas QKB) sipas përcaktimeve në ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore” i ndryshuar, neni 5, pika c.

Kriteri konsiderohet i permbyllur me plotësimin e formularit sipas shtojcës 8 të DT.

Ndërsa operatori ekonomik i kualifikuar i pari përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve ankimit ,duhet te dorezoje prane AK ,dokumentat provuese per vetdeklarimet ne formularin permbylledhes te vetdeklarimit,sic kerkohet ne piken 2.2.3,duke dorezuar dokumentacionin origjinal ose kopje te njesuara me origjinalin.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 1 dhe 3, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, si dhe nenit 43, nenit 41, pika 5/ c), të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” dhe në ligjin nr.9632, datë 30.10.2006 “Për Sistemin e Taksave Vendore” i ndryshuar, në ligjin nr.9920 datë 19.05.2008 “Per procedurat tatimore” i ndryshuar, neni 3.1/a, b, c dhe neni 40, në ligjin nr.131/2015 “Per QKB” i ndryshuar, si dhe në ligjin nr.9723 datë 03.05.2007 “Per QKR” i ndryshuar.

Meqenëse operatorët ekonomik kanë detyrimin të paguajnë të gjitha detyrimet e taksave dhe tarifave vendore, në vendet që ushtrojnë aktivitetin e tyre, atëherë operatorët ekonomikë pjesëmarrës duhet të vërtetojnë se i kanë likuiduar këto detyrime nëpërmjet paraqitjes së vërtetimit të lëshuar nga Administrata e Qeverisjes Vendore.

2.3 Aftësitë teknike dhe profesionale:

2.3.1. Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për përvojën e mëparshme të ngjashme:

a) punë të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë jo më të vogël se **50%** e vlerës së përlogaritur të kontratës që prokurohet dhe konkretisht: **28,561,666** (Njezet e tete milion e peseqind e gjashtedhjetë e nje mije e gjashteqind e gjashtedhjetë e gjashtë) lekë dhe që është realizuar gjatë pesë viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, ose

b) punë të ngjashme deri në një kufi, ku vlera monetare totale e punëve të kryera, e marrë së bashku gjatë pesë viteve të fundit, është jo më e vogël se dyfishi i vlerës limit të kontratës që prokurohet dhe konkretisht **114,246,664** (Njeqind e katermbedhjetë mije e dyqind e dyzet e gjashtë mije e gjashteqind e gjashtedhjetë e kater)leke

Plotësimi i njërit prej dy kushteve të sipërpërmendura e bën ofertën të kualifikueshme.

Pika a plotësohet nga anëtari i cili ka përqindjen më të madhe të pjesëmarrjes në bashkim. Anëtarët e tjerë të bashkimit do të paraqesin kontratat e ngjashme në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim.

Kurse pika b duhet të plotësohet nga të gjithë anëtarët e bashkimit në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim.

Në rastin kur Operatorët ekonomik, anëtarë të një bashkimi, kanë të njëjtën përqindje pjesëmarrjeje në bashkim, vendosin me marrëveshje në Kontratën e Bashkëpunimit se cili prej tyre do ta përmbushë këtë kusht.

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

- a) Për kontrata të realizuara me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë dokumentacionin e mëposhtëm:
 - Formular vlerësimi për realizimin e punimeve sipas shtojcës Nr. 9, shoqëruar me:
 - Kontratë Sipërmarrje
 - Situacionin përfundimtar;
 - Aktin e kolaudimit;
 - Çertifikaten e marrjes në dorezim/Çertifikatën e Përkohshme të marrjes në dorezim
- b) Për kontrata të realizuara me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë dokumentacionin e mëposhtëm:
 - Kontrate Sipërmarrje;
 - Situacionin përfundimtar;
 - Akt kolaudimi objekti;
 - Çertifikaten e marrjes në dorezim/ Çertifikatën e Përkohshme të marrjes në dorezim.
 - Fature tatimore perkatese të deklaruar në organet tatimore.
- c) Për kontratat e realizuara si Bashkim Operatorësh, Operatorët ekonomikë ofertues duhet të paraqesë: Kontratën e Bashkimit të operatorëve ekonomikë si dhe prokurën e posaçme të deklaruar në fazën e tenderimit.
- d) Për kontratat e realizuara si Nënkontraktor, Operatorët ekonomikë ofertues duhet të paraqesë: Kontratën bazë ndërmjet Kontraktorit dhe Autoritetit Kontraktor; si dhe Miratimi zyrtar si nënkontraktor i deklaruar nga ana e autoritetit kontraktor.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 4 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, *ne lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zoterojnë burimet e nevojshme njerezore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të pershtatshëm cilësie. Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvojë që vërtetohet nga referenca të pershtatshme nga kontrata e zbatuara në të shkuarën.*

Autoriteti Kontraktor (AK) argumenton se kërkesa për punë të ngjashme synon të vlerësojë përvojën e nevojshme të ofertuesve. Vlerësimi i kësaj përvojë kryhet nëpërmjet paraqitjes së dokumentacionit të kërkuar sipas pikave përkatëse, i cili provon eksperiencën në realizimin e punëve publike të ngjashme dhe përbën një garanci shtesë për AK-në në funksion të përmbushjes me sukses të kontratës objekt prokurimi.

Nga praktika e ndjekur gjatë fazës së vlerësimit të ofertave, AK ka konstatuar vështirësi në vlerësimin sa më objektiv të përvojës së ngjashme, për shkak se jo të gjitha institucionet publike apo private lëshojnë Formularin e Vlerësimit sipas formatit zyrtar, ku përcaktohet ndarja në përqindje e punimeve të realizuara.

Në funksion të një vlerësimi sa më të drejtë dhe transparent të ofertave, në rastet e Bashkimit të Operatorëve Ekonomikë (BOE) ose të nënkontraktimit, përvoja e pretenduar duhet të vërtetohet përmes paraqitjes së kontratës së bashkëpunimit, marrëveshjes së nënkontraktimit, si dhe aktit të miratimit të nënkontraktimit të lëshuar nga institucioni përkatës.

Ky dokumentacion disponohet nga çdo operator ekonomik, si në rastin kur ka qenë pjesë e një BOE-je, ashtu edhe kur ka vepruar si nënkontraktor. Ai është lehtësisht i aksesueshëm dhe përbën pjesë të dosjes së zbatimit të punimeve të kontratës, të cilën çdo kompani duhet ta administrojë. Për rrjedhojë, kjo kërkesë nuk sjell kufizim të pjesëmarrjes së operatorëve ekonomikë në procedurën e tenderimit, as në mënyrë të drejtpërdrejtë dhe as të tërthortë.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme argumentohet si më poshtë:

Duke qenë se vlera e parashikuar e kontratës ndodhet ndërmjet kufijve monetarë të përcaktuar nga legjislacioni në fuqi, është kërkuar që operatorët ekonomikë të kenë realizuar punë të ngjashme në një vlerë minimale prej 50% të fondit limit për një kontratë të vetme, ose në një vlerë totale të barabartë me fondin limit të kontratës që prokurohet, për punë të ngjashme të kryera gjatë 5 viteve të fundit. Kjo kërkesë është në përputhje me kufijtë e përcaktuar në dispozitat ligjore përkatëse dhe përbën një nivel të mjaftueshëm përvojë, duke marrë në konsideratë natyrën dhe vlerën e kontratës.

Në këtë mënyrë, Autoriteti Kontraktor siguron besueshmërinë dhe garancinë e nevojshme që operatori ekonomik ofertues zotëron kapacitetet për realizimin e kontratës pa pengesa që mund të ndikojnë në ecurinë e punimeve.

Përvoja e mëparshme përbën një element thelbësor, pasi garanton se operatorët ekonomikë, mbi bazën e kontratave të ngjashme të realizuara, disponojnë kapacitetet teknike dhe organizative për të zbatuar kontratën me sukses dhe në përputhje me standardet e kërkuara të

cilësisë. Vlera e kërkuar është në raport proporcional me objektin e prokurimit dhe nuk sjell kufizim të konkurrencës.

Në mbështetje të nenit 39, pika 8, të VKM nr. 285/2021, autoriteti/enti kontraktor, përveç kërkesave të parashikuara në këtë nen, mund të përcaktojë edhe kritere të tjera të veçanta, në varësi të objektit që prokurohet, të cilat vlerësohen të nevojshme për ekzekutimin me sukses të kontratës.

Gjithashtu, në zbatim të Ligji nr. 8402/1998 (i ndryshuar), si dhe akteve nënligjore përkatëse, përfshirë udhëzimet për zbatimin, mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit, dhe duke qenë se kontrata për punë publike që prokurohet është me matje, sipas nenit 39, pika 1/a të VKM-së, lind nevoja që operatorët ekonomikë pjesëmarrës, për të vërtetuar përmbushjen e kërkesave të përcaktuara në nenin 39, pika 5/a dhe 5/b, të paraqesin dokumentacionin përkatës.

Ky dokumentacion përfshin: formularin e vlerësimit për realizimin e punimeve (sipas shtojcës nr. 9), kontratat e sipërmarrjes, situacionet përfundimtare, aktin e kolaudimit, si dhe certifikatën e marrjes në dorëzim (ose certifikatën e përkohshme të marrjes në dorëzim) për punët e realizuara me entet publike. Nëpërmjet këtij dokumentacioni, Autoriteti Kontraktor bindet se operatori ekonomik përmbush kriterin për punë të ngjashme, duke verifikuar zërat e punimeve të realizuara, afatin e përfundimit, dokumentacionin e kolaudimit dhe të marrjes në dorëzim, si dhe vlerësimin e dhënë nga autoriteti kontraktor përkatës.

Përvoja e mëparshme mbetet një element thelbësor që i jep siguri Autoritetit Kontraktor se operatorët ekonomikë, mbi bazën e punëve të ngjashme të realizuara, zotërojnë kapacitetet e nevojshme për të zbatuar kontratën me sukses dhe në përputhje me standardet e kërkuara të cilësisë.

2.3.2 Operatori ekonomik ofertues duhet të jetë i pajisur me licencë profesionale sipas modelit të lëshuar nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë e cila të përmbajë kategoritë e mëposhtme:

Punime të përgjithshme ndërtimi:

Kategoria NP-1 Niveli A “Punime germimi”

Kategoria NP-4 Niveli B “Rruge ,autostrada,mbikalime..”

Kategoria NP-12 Niveli A “Punime te inxhinierise se mjedisit”

Punime speciale ndertimi:

Kategoria NS-1 Niveli A “Punime per prishjen e ndertimeve”

Kategoria NS-6 Niveli A “Sinjalistike rrugore jo ndricuese”

Kategoria NS-8 Niveli A “Ndertime parafabrikat b/a ,struktura metalike dhe druri

Kategoria NS-18 Niveli A “Punime topogjeodezike”..

sipas modelit të lëshuar nga institucioni përgjegjës për dhënien e licensave profesionale sipas legjislacionit në fuqi.

Operatorët e huaj duhet të bëjnë ekuivalentimin e licensave profesionale që disponojnë të lëshuara nga vendi i origjinës, pranë Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë, (ose Ministrisë kompetente të kohës) Republika e Shqipërisë. (Rregullorja për kriteret dhe

procedurat e dhënies së licensave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike që ushtrojnë veprimtari ndërtimi, e miratuar me VKM- në, Nr.42, datë 16.01.2008). Mosparaqitja në këtë formë është kusht skualifikues.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar në mbështetje të nenit 77 të Ligji nr. 162/2020, si dhe nenit 39, pika 6/a, të VKM nr. 285/2021. Gjithashtu, ajo bazohet në VKM nr. 42/2008, i ndryshuar, “Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së licensave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike që ushtrojnë veprimtari ndërtimi”.

Përcaktimi i kategorive të licensave mbështetet në kriteret të qarta ligjore dhe teknike. Të dhënat mbi licencat e kërkuara janë referuar në përputhje me legjislacionin për ndërtimet, konkretisht me Ligji nr. 8402/1998, i ndryshuar. Neni 8 i këtij ligji parashikon se zbatimi i punimeve të ndërtimit kryhet vetëm nga persona juridikë, privatë ose publikë, vendas apo të huaj, të pajisur me licencën përkatëse për zbatim punimesh ndërtimore.

Zbatuesi i punimeve mban përgjegjësi të plotë për realizimin e tyre në përputhje me lejen e ndërtimit, projektin, kushtet teknike të zbatimit dhe rregullat e sigurimit teknik. Ai është i detyruar të garantojë cilësinë e materialeve dhe produkteve të ndërtimit, të cilat duhet të përmbushin kërkesat e projektit dhe standardet kombëtare ose evropiane në fuqi.

Niveli i kategorive të licensës së kërkuar është në përputhje me natyrën e objektit dhe fondin limit të prokurimit, duke synuar të sigurojë që operatorët ekonomikë të disponojnë aftësitë e nevojshme tekniko-profesionale për realizimin e kontratës.

Nëpërmjet këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të provojnë se zotërojnë licencat profesionale të parashikuara nga legjislacioni në fuqi, të lëshuara nga autoritetet kompetente, për kryerjen e punimeve objekt kontrate. Licencat lidhen drejtpërdrejt me zërat konkretë të punimeve të ndërtimit dhe përbëjnë një garanci për përmbushjen me cilësi dhe përgjegjësi të detyrimeve kontraktore.

Për pjesëmarrje në procedurat e prokurimit, operatorët ekonomikë duhet të kualifikohen duke përmbushur të gjitha kriteret e vendosura nga autoriteti kontraktor, për sa kohë këto kriteret janë në proporcion me natyrën dhe përmasat e kontratës që prokurohet.

Kategoritë e kërkuara janë kërkuar bazuar në zërat dhe vlerat e punimeve, si më poshtë:

Kategoria e kërkuar	Pershkrimi i kategorisë sipas legjislacionit të fushës	Zërat e punimeve që parashikohen të kryhen në preventiv, që përfshihen në kategorinë përkatëse	Niveli i klasifikimit i kërkuar për kategorinë respektive	Vlera e punimeve që parashikohen të kryhen në preventiv, që përfshihen në kategorinë përkatëse
<u>Kategoria NP-1</u>	Punime germimi	Zeri nr. 1 Kap. 1	Niveli A	426,160 leke pa tvsh
<u>Kategoria NP-4</u>	Rruge, autostrada, mbikalime	Zeri nr (3-8) Kap. 2, zeri nr(9-10) Kap3,zeri nr (11-12)	Niveli B	45,394,501leke pa tvsh

		Kap 4, zeri nr 13 Kap 5, zeri nr 14 Kap 6, zeri nr 24 Kap 10,		
<u>Kategoria NP-12</u>	Punime te inxhinierise se mjedisit	Zeri nr. (22-23) Kap 10, zeri nr 29 Kap 15	Niveli A	3,888,990 leke pa tvsh
<u>Kategoria NS-1</u>	Punime per prishjen e ndertimeve	Zeri 27 Kap	Niveli A	98,218 leke pa tvsh
<u>Kategoria NS-6</u>	Sinjalistike rrugore jo ndriçuese	Zeri nr. (15-16) Kap 7, zeri nr (17-18) Kap 8, zeri nr (19-21) Kap 9, zeri nr 30 Kap 15	Niveli A	4,612,913 leke pa tvsh
<u>Kategoria NS-8</u>	Ndertime parafabrikat b/a ,struktura metalike dhe druri	Zeri nr 25 Kap 11	Niveli A	646,814 leke pa tvsh
<u>Kategoria NS-18</u>	Punime topogjeodezike		Niveli A	

2.3.3 Operatori ekonomik ofertues duhet te kete te punesuar staf inxhinierik të perfshirë ne liçensen e shoqerise për kryerjen e të gjitha punimeve në objekt te pakten:

- 1(nje) inxhinier ndërtimi
- 1(nje) inxhinier topograf

Inxhinieret e mësipërm duhet të jenë të siguar dhe të figurojnë me kohë të plotë në listëpagesat perkatese E-Sig për të paktën **3(tre) muajt e fundit**.

Lidhur me këtë pikë operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë Kontratën individuale të punës, Diplomën e inxhinierëve të mësipërm.

Kriteri konsiderohet i permbushur me plotesimin e formularit sipas shtojcës 8 të DT.

Ndersa operatori ekonomik i kualifikuar i pari përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve ankimit ,duhet te dorezoje prane AK ,dokumentat provuese per vetdeklarimet ne formularin permbledhes te vetdeklarimit,sic kerkohet ne piken 2.3.3,duke dorezuar dokumentacionin origjinal ose kopje te njesuara me origjinalin.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 4 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar: ”Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie” ne nenin 39, pika 6, gërma c) të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar si dhe ligjin 8402 “Per kontrollin dhe disiplinimin e punimeve te ndertimit” date 10.09.1998 i ndryshuar.

Kriteri për stafin drejtues teknik, lidhet ngushtësisht me objektin e kontrates, relacionin teknik dhe zërat e punimeve. Nevoja për inxhinierët në objekt është e diktuar nga përvoja dhe legjislacioni për punimet e ndërtimit. Mungesa e këtij stafi pothuajse në çdo rast rezulton në realizim jashtë afatit, jashtë normave dhe me cilësi të dobët të objekteve. Numri i stafit kryesor teknik si numri i inxhinierëve **të ndërtimit dhe topograf** është përcaktuar nga pikëpamja e

*natyrës teknike të kontratës me qëllimin për të patur një rezultat sa më të mirë në mbarëvajtjen dhe zbatimin e punimeve. Operatorët ekonomikë duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, për të zbatuar kontratën. Drejtuesi i teknik është përgjegjës për ndërtimin në përputhje me kushtet teknike të zbatimit, sigurimin teknik dhe mbrojtjen në punë brenda kushteve të kontratës. Bazuar në parashikimet e mësipërme të legjislacionit për prokurimin publik, Autoriteti Kontraktor ka kërkuar që operatori ekonomik ofertues duhet të ketë në stafin e tij **drejtues teknik** të cilët kanë një rol të rëndësishëm në mbarëvajtjen e punimeve pasi ata janë përgjegjës për zbatimin e objektit sipas projektit dhe në përputhje me kushtet teknike të zbatimit të tij.*

Kërkesa specifike për Inxhinierët e kërkuar është përcaktuar në kuadër të analizës teknike që i është bërë Preventivit të Punimeve (nga ku përcaktohet qartazi dhe profili inxhinierik) si dhe në bashkrendim me kategoritë e kërkuara në Licencën profesionale të shoqërisë sipas pikës 2.3.2 , kapaciteti teknik në DST. Duke marrë në konsideratë Projektin e zbatimit si dhe Preventivin e Punimeve rezulton se është e domosdoshme që çdo Ofertues të ketë pjesë të stafit Inxhinierë të kërkuar si me siper, të cilët në bashkëpunim me njëri tjetrin si dhe me fuqinë punëtore të shoqërisë do të realizojnë me sukses kontratën objekt prokurimi.

Është kërkuar angazhimi i një inxhinieri ndërtimi për zbatimin e punimeve në përputhje me zërat e preventivit, projektin, specifikimet teknike dhe kategoritë përkatëse të përcaktuara në licencën e zbatimit. Inxhinieri i ndërtimit mban përgjegjësi për realizimin korrekt të projektit për secilin zë punimesh, si dhe për cilësinë e materialeve që përdoren dhe vendosen në objekt. Gjithashtu, është kërkuar angazhimi i një inxhinieri topograf, i cili do të kryejë punimet topografike për përcaktimin e kuotave të gërmimeve, kuotave të shtresave rrugore, hartimin e planit të kullimit të ujërave sipërfaqësore në kuneta, si dhe përcaktimin e kuotave për vendosjen e tubacioneve të rrjeteve inxhinierike, etj.

2.3.4 Vetdeklarimin nga inxhinierët e mësipërm se ata janë të disponueshëm për realizimin e kësaj kontrate.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është bazuar në Rekomandimin Nr. 6732 datë 21.10.2020 "Mbi problematikat e konstatuara gjatë monitorimit nga APP".

2.3.5 Operatori ekonomik ofertues, me anë të një deklarate (nga Administratori i shoqërisë) duhet të përcaktojë **Drejtuesin Teknik të punimeve në objekt**, i cili duhet të jetë i përfshirë në licensën e shoqërisë dhe të deklarojë se nuk është i angazhuar në kontrata të tjera dhe do të jetë i pranishëm gjatë gjithë kohës që do të kryhen punimet në objekt. Bashkelidhur deklaratës për Drejtuesin Teknik duhet të paraqitet; a) Kontrata e punës e vlefshme dhe b) Diploma.

Në rastin e bashkimit të operatoreve ekonomik secili Operator duhet të përcaktojë me anë të një deklarate Drejtuesin Teknik të punimeve në objekt, i cili duhet të jetë i përfshirë në licencën e shoqërisë dhe të deklarojë se nuk është i angazhuar në kontrata të tjera dhe të jetë i pranishëm

gjate gjithë kohës që do të kryhen punimet në objekt në varesi të vlerës së preventivit të punimeve që ka marrë persiper sipas përqindjes së bashkepunimit.

Kriteri konsiderohet i permbyshur me plotësimin e formularit sipas shtojcës 8 të DT.

Ndërsa operatori ekonomik i kualifikuar i pari përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afatëve ankimit, duhet të dorëzojë pranë AK, dokumentat provuese për vetdeklarimet në formularin permbylës të vetdeklarimit, siç kërkohej, duke dorëzuar dokumentacionin origjinal ose kopje të njësuar me origjinalin.

Argumentimi: *Së pari, kjo kërkesë mbështetet në Ligjin Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, Neni 77, pika 4, si dhe në VKM Nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, Kreu V, Seksioni III, Neni 39, pika 6, gërma “c”.*

Së dyti, duke qenë se objekt prokurimi është kontratë pune sqarojmë se detyrimin për prezencën e Drejtuesit Teknik gjatë gjithë kohës që do të kryhen punimet në objekt e përcakton qartazi Udhëzimi Nr. 2, datë 13.05.2005 “Për zbatimin e punimeve të ndërtimit”, konkretisht pika 1.2 ku citohet se: “drejtuesit ligjore dhe teknik të sipërmarrësit janë përgjegjës përpara investitorit për ndërtimin e veprës, sipas projektit, për kryerjen e punimeve të ndërtimit, në përputhje me kushtet teknike të zbatimit, specifikimet teknike, sigurimin teknik dhe mbrojtjen në punë, brenda kushteve të kontratës e dispozitave ligjore në fuqi” si dhe pikës 2.1 ku citohet se “drejtimi teknik i punimeve në kantier sigurohet, sipas rastit, drejtpërdrejtë nga drejtuesi teknik i sipërmarrësit ose përgjegjësi teknik i kantierit.

Lidhur me kërkesën që Drejtuesi Teknik i punimeve në objekt duhet të jetë i përfshirë në licencën e shoqërisë dhe të mos jetë i angazhuar në kontrata të tjera, mbështetet në Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr. 42, datë 16.1.2008 “Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike, që ushtrojnë veprimtari ndërtimi”, pika 2 ku përcaktohet se: “Papajftueshmëritë me detyrën e drejtuesit teknik të shoqërisë së zbatimit Drejtuesit teknikë të shoqërisë nuk mund të jenë personat që janë të angazhuar në çdo punë-marrje tjetër publike. Drejtuesi teknik i shoqërisë nuk mund të jetë njëkohësisht i punësuar në dy apo më shumë shoqëri ndërtimi dhe ndalohej të disponojnë licencë për mbikëqyrje e kolaudim të punimeve të zbatimit” dhe pika 2: “elementët e licensës” gërma “c” ku citohet se: “Licencat e shoqërive jepen me afat të njëjtë me atë për të cilin janë regjistruar për të ushtruar veprimtari në QKR apo gjykatë. Ndalohej ushtrimi i veprimtarisë zbatuese në ndërtim në mungesë të drejtuesit/ve teknikë të shoqërisë. Shoqëritë e licencuara jo më vonë se 10 ditë kalendarike, kur drejtuesi teknik është dorëhequr ose ka pamundësi fizike për ushtrimin e detyrës (aksident, sëmundje me paafësi ushtrimi detyre mbi 14 ditë, invaliditet, ndarje nga jeta), kanë detyrimin të paraqesin njoftim së bashku me kërkesën për drejtuesin e ri teknik të shoqërisë”.

Për sa më lart, çdo kërkesë e renditur për Drejtuesin Teknik, buron nga kontrata e punës objekt prokurimi, me qëllim permbyshjen dhe realizimin e saj sipas kushteve dhe dispozitave ligjore në fuqi.

2.3.6 Operatori/et ekonomik duhet të kenë në stafin e tyre personel të kualifikuar/certifikuar si:

1 (një) punonjës me certifikatë "Përgjegjës për sigurinë dhe mbrojtjen e shëndetit në punë" në përputhje me klauzolat e Ligjit Nr. 10327 datë 18/02/2010 "Për sigurinë dhe shëndetin në punë" dhe V.K.M Nr. 312, date 05.05.2010 "Për miratimin e rregullores "Për sigurinë në kantier", shoqëruar me kontratë individuale pune të vlefshme, Diplome/certifikate, si dhe të figurojë në listëpagesat e shoqërisë minimumi per periudhen e fundit te deklaruar nga data e hapjes se ofertave.

(Në rastin e Bashkimit të Operatorëve ekonomikë, secili nga Operatorëve duhet të ketë pjesë të stafit të tij 1 (nje) punonjës "Përgjegjës për sigurinë dhe mbrojtjen e shëndetit në punë" sipas zerave te punimeve qe marrin persiper ne realizim e kontrates sipas aktmarreveshjes).

Kriteri konsiderohet i permbushur me plotesimin e formularit sipas shtojcës 8 të DT.

Ndersa operatori ekonomik i kualifikuar i pari përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve ankimit ,duhet te dorezoje prane AK ,dokumentat provuese per vetdeklarimet ne formularin permbledhes te vetdeklarimit, sic kerkohet, duke dorezuar dokumentacionin origjinal ose kopje te njesuara me origjinalin.

Argumentimi: Kërkesa për Përgjegjësin për sigurinë dhe mbrojtjen e shëndetit në punë është vendosur sipas përcaktimeve të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 "Për Prokurimin Publik", Neni 77, pika 4; të VKM-së Nr. 285 datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", Kreu V, Seksioni III, Neni 39, pika 6, gërma "c", si dhe në mbështetje të Nenit 7 të Ligjit Nr. 10237, datë 18.02.2010, "Për sigurinë dhe shëndetin në punë", sipas të cilit: „Punëdhënësi ngarkon një ose disa punëmarës që të merren me çështjet e mbrojtjes, të sigurisë e shëndetit në punë.....“.

Theksojmë se Autoriteti Kontraktor synon realizimin e kontratës objekt prokurimi në përputhje të plotë me kushtet e përcaktuara në Dokumentet Standarde të Tenderit (DST), duke respektuar të gjitha rregullat që lidhen me administrimin e kantierit të ndërtimit dhe garantimin e sigurisë së punonjësve gjatë ushtrimit të aktivitetit.

Është thelbësore që punimet të zhvillohen në një kantier të sigurt, duke mbrojtur jo vetëm jetën dhe shëndetin e punonjësve, por edhe të personave të tretë apo kalimtarëve që mund të ndodhen pranë zonës së punimeve. Në këtë kuadër, prania e një punonjësi të certifikuar si "Përgjegjës për sigurinë dhe mbrojtjen e shëndetit në punë" është e domosdoshme. Nëpërmjet njohurive dhe përvojës së tij profesionale, ky specialist duhet të identifikojë, parandalojë dhe minimizojë çdo rrezik potencial që mund të shfaqet gjatë veprimtarisë së shoqërisë dhe që mund të cenojë sigurinë dhe shëndetin në punë.

Vendosja e këtij kriteri përbën një garanci shtesë se ofertuesit do të realizojnë punimet në përputhje me standardet ligjore dhe teknike në fuqi.

Gjithashtu, duke marrë në konsideratë natyrën e punimeve, të cilat paraqesin rrezik potencial për incidente apo aksidente me pasoja zjarri, kërkohet angazhimi i një specialisti për hartimin e planit të masave parandaluese dhe planit të evakuimit në rast emergjencash nga zjarri. Për këtë arsye, konsiderohet e nevojshme dhe e domosdoshme prania e një (1) punonjësi të pajisur me certifikatën "Ekspert për ndihmën e parë dhe ndërhyrjen ndaj emergjencave", në funksion të garantimit të reagimit të shpejtë dhe efektiv në situata emergjente.

2.3.7 Operatori ekonomik ofertues duhet të ketë numrin e nevojshëm të punonjësve për realizimin dhe zbatimin e kontratës. Numri mesatar i punonjësve të siguruar për **3 (tre) muajt e fundit** duhet të jetë **15 (pesëmbëdhjetë)**.

Lidhur me këtë pikë operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë vërtetimin të lëshuar nga Dega e Tatimit Taksave ose Dega e Sigurimeve Shoqërore dhe Shëndetsore në të cilin të jetë i përcaktuar numri i punonjësve të siguruar për periudhën e mësipërme, shoqëruar me listat e pagesave përkatëse E-Sig, për kontributet e sigurimeve shoqërore dhe shëndetsore.

Kriteri konsiderohet i përmbushur me plotësimin e formularit sipas shtojcës 8 të DT.

Nëse operatori ekonomik i kualifikuar i pari përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afatit të punës, duhet të dorëzojë pranë AK dokumentat provuese për vetdeklarimet në formularin përmbledhës të vetdeklarimit, siç kërkohej, duke dorëzuar dokumentacionin origjinal ose kopje të njësuar me origjinalin.

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për 00 prokurimin publik” dhe 39, pika 6, gërma Ç, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohej që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë fuqinë punëtore të të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, që ka në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën.

Numri i përcaktuar i punonjësve është përllogaritur si më poshtë:

Afati 6 (gjashtë) muaj. Sasia e orëve të punës sipas manualit sipas zerave të punimeve është $13104:8:132=12.4$ punonjës

Nevojitet

1 (një) Teknik ndërtimi nevojitet për organizimin e punimeve në objekt

- 1 (një) murator nevojitet për kryerjen e punimeve të ndërtimit, sasia e orëve të punës sipas manualit është $934:8:132=0.88$ punonjës (1 specialist).

- 2 (dy) asfaltshtrues nevojitet për kryerjen e procesit të asfaltimit, sasia e orëve të punës sipas manualit është $1546:8:132=1.46$ punonjës (2 specialistë)

- 1 (një) mekanik nevojitet për kryerjen e punimeve sipas zerave të preventivit. Sasia e orëve të punës sipas manualit është $155:8:132=0.146$ punonjës (1 specialist)

- 3 (tre) manovratorë nevojiten për kryerjen e punimeve sipas zerave të preventivit. Sasia e orëve të punës sipas manualit është $4538:8:132=4.2$ manovratorë (3 manovratorë + 1 ndihmës)

- 1 (një) punonjës gjelberimi nevojitet për kryerjen e punimeve të gjelberimit në objekt si mbjellje bari, mbjellje pemesh etj. Sasia e orëve të punës sipas manualit është $404:8:132=0.38$ punonjës

2-shoferë

3-manovrator

Totali 15 (pesëmbëdhjetë) punonjës

Në lidhje me vërtetimin të lëshuar nga Administrata Tatimore si dhe listat e punonjësve kjo kërkesë është e mbështetur në Nenin 39, pika 8 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” sipas së cilës: “Autoriteti/enti kontraktor, përveç

kërkesave të parashikuara në këtë nen, mund të përcaktojë kritere të tjera të veçanta, në varësi të objektit që prokurohet, të cilat i vlerëson të nevojshme për ekzekutimin me sukses të kontratës”.

2.3.8 Operatori ekonomik ofertues duhet të ketë të punësuar staf teknik për kryerjen e punimeve të pasqyruar në listëpagesa për të paktën **3 (tre) muajt e fundit**, të paisur me kontratë pune (te vlefshme), një dokument që të vërtetojë kualifikimin profesional (dëshmi kualifikimi profesional/certifikatë/diplomë), lëshuar nga institucione (shtetërore apo private) të licencuara/akredituara nga autoritetet përgjegjëse shtetërore, sipas ligjit nr. 15/2017 “Për arsimin dhe formimin profesional në Republika e Shqipërisë” ose të kontraktuar në rastin kur makineritë janë me qera, të paktën:

- Murator	1 (nje) punonjes
- Mekanik	1 (nje) punonjes
- Asfaltoshtrues	2 (dy) punonjes
- Punonjes gjelberimi	1 (nje) punonjes

Manovratorët duhet të jenë punonjës të specializuar për drejtimin e mjeteve të rënda (Eskavatorist) dhe (Automakinist) dhe për këtë duhet të paraqesin dëshmi nga Drejtoria e Shërbimit të Transportit Rrugor .

Kriteri konsiderohet i përmbushur me plotësimin e formularit sipas shtojcës 8 të DT.

Ndërsa operatori ekonomik i kualifikuar i pari përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afatëve ankimit, duhet të dorëzojë pranë AK ,dokumentat provuese për vetdeklarimet në formularin përmbledhës të vetdeklarimit,sic kërkohej në pikën 2.3.8,duke dorëzuar dokumentacionin origjinal ose kopje të njësuar me origjinalin.

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe 39, pika 6, gërma Ç, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021“Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë stafin, personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës. Konkretisht:

- 1 (një) murator nevojiten për kryerjen e punimeve të ndërtimit, sasia e orëve të punës sipas manualit është $934:8:132=0,88$ punonjes(1specialist).

- 2 (dy) asfaltoshtrues nevojitet për kryerjen e procesit të asfaltimit, sasia e orëve të punës sipas manualit është $1546:8:132=1,46$ puntore. (2 specialist)

- 1 (një) mekanik nevojitet për kryerjen e punimeve sipas zerave të preventivit. Sasia e oreve të punës sipas manualit është $155:8:132=0.146$ puntore(1 specialist)

- 3 (tre) manovrator nevojiten për drejtimin e mjeteve të rënda sipas preventivit për mjetet: skreper, rrul, autobitumatricë, asfaltoshtruese, minifadrome, grejder, autvinç. Sasia e oreve të punës sipas manualit është $4538:8:132=4.2$ manovrator(3manovrator+1ndihmes)

-1(nje)punonjes gjelberimi nevojitet për kryerjen e punimeve të gjelberimit në objekt si mbjellje bari,mbjellje pemesh etj.Sasia e oreve të punës sipas manualit është $404:8:132=0.38$ punonjes

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe 39, pika 6, gërma ç, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë stafin, personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës. Konkretisht:

Të gjithë specialistët e kërkuar janë në përputhje të plotë me projektin dhe preventivin, duke marrë në konsideratë volumet e punës që do të realizohen, si dhe afatin e zbatimit të tyre. Autoriteti Kontraktor duhet të ketë garancinë se punimet do të kryhen nga persona të kualifikuar, me eksperiencë të mjaftueshme profesionale, në mënyrë që zbatimi të bëhet në përputhje me standardet e përcaktuara në specifikimet teknike.

Për këtë arsye, për vërtetimin e kualifikimit të stafit teknik është kërkuar që specialistët të jenë të pajisur me diploma/dëshmi përkatëse, të lëshuara nga institucione të akredituara nga autoritetet shtetërore përgjegjëse. Certifikimet dhe diplomat profesionale duhet të jenë të lëshuara nga institucione të licencuara nga organet kompetente, në mbështetje të ligjit Nr. 15/2017 “Për arsimin dhe formimin profesional në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.

Në zbatim të këtij legjislacioni, certifikimet profesionale ofrohen nga institucione të licencuara nga ministria përgjegjëse, nëpërmjet Agjencia Kombëtare e Arsimit, Formimit Profesional (AKAFP). Certifikatat e specialistëve duhet të jenë të regjistruara në regjistrat profesionale të AKAFP-së, duke garantuar vlefshmërinë dhe njohjen zyrtare të tyre.

Gjithashtu, kërkesa për dëshmitë e manovratorëve mbështetet në Urdhri nr. 200/2019, “Për miratimin e rregullores për kushtet, kriteret dhe programet për përgatitjen teoriko-praktike të kandidatëve, si dhe dhënien e dëshmisë së aftësisë profesionale për përdoruesit e makinerive të rënda për punime ndërtimi dhe toke, si dhe disiplinimin e përdorimit të makinerive të ndërtimit”, duke siguruar që operatorët e makinerive të rënda të jenë të trajnuar dhe të certifikuar sipas kërkesave ligjore në fuqi.

2.3.9 Ofertuesi duhet të disponojë minimalisht mjetet e mëposhtme për kryerjen e punimeve, me qëllim realizimin e objektit të prokurimit :

Nr	Mjetet	Sasia
1	Mjet transporti veteshkarkues ≥ 15 ton (kapac.mбайtes)	2 cope
2	Kamionçina(kap mbajtes) (3-5)ton	1 copë
3	Skreper	1 copë
4	Betoniëre	1 copë
5	Grejder	1 cope
6	Autobot uji	1 cope
7	Rrul me vibrim per ngjeshje çakelli	1 cope
8	Rrul per ngjeshje asfalti me kapacitet mbi 8 ton	1 cope
9	Autobitumatriçe	1 cope
10	Asfaltoshtruese	1 cope
11	Autovinç	1 cope
12	Matrapik	1 cope

13	Minifadrome	1 cope
14	Autobetoniere	1 cope
15	Eskavator me goma me kapacitet 2 m3	1 cope
16	Sperkates boje per vizime ne rruge(makineri ose paisje)	1 cope

Si dëshmi per plotësimin e kesaj pike Operatori duhet te paraqese:

- i. Për mjetet në pronësi që shënohen në regjistra publikë, të paraqitet dokumenti që vërteton regjistrimin e mjetit (leja e qarkullimit), çertifikata e kontrollit teknik, siguracioni i mjetit, si edhe çertifikatën për transport mallrash brënda vëndit, (e vlefshme).
- ii. Për mjetet që nuk shënohen ne regjistrat publikë, duhet të paraqitet dokumenti që vërteton pronësinë e tyre: aktet e zhdoganimit ne Republikën e Shqiperisë ose faturat tatimore te blerjes.
- iii. Për të gjitha mjetet e marra me qira, të paraqitet kontrata ku të specifikohet afati i kontratës.
- iv. Per mjetet e marra me qera qe shenohen ne rregjistra publik, duhet te paraqitet dokumenti që vërteton regjistrimin e mjetit (leja e qarkullimit), çertifikata e kontrollit teknik, siguracioni i mjetit, si edhe çertifikata për transport mallrash brënda vëndit, (e vlefshme). Kurse per mjetet që nuk shënohen ne regjistrat publikë, duhet të paraqitet dokumenti që vërteton pronësinë e tyre, aktet e zhdoganimit ose faturat tatimore te blerjes.

Kriteri konsiderohet i permbushur me plotesimin e formularit sipas shtojcës 8 të DT.

Ndersa operatori ekonomik i kualifikuar i pari përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve ankimit, duhet te dorezoje prane AK ,dokumentat provuese për vetdeklarimet në formularin permbledhës të vetdeklarimit, siç kërkohet, duke dorëzuar dokumentacionin origjinal ose kopje të njesuara me origjinalin.

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 39, pika 6/d, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021“Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë mjetet e pajisjet teknike, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, që ka në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën.

Për të përcaktuar llojin dhe numrin e mjeteve/makinerive të nevojshme për realizimin e kontratës, janë hartuar analizat teknike, sipas legjislacionit të fushës, sipas zerave te preventivit dhe specifikimeve teknike te hartuara nga specialistet e fushes.

Dokumentacioni shoqërues i kërkuar për makineritë provon certifikimin ligjor dhe teknik të mjeteve të disponuara përmes kontratës së shitjes apo të qirasë. Ky dokumentacion i jep garanci A.K se punimet do të realizohen me cilësi, siguri dhe në respektim të afateve të parashikuara në Grafikun e punimeve.

1-Mjet transporti vetshkarkues ≥ 7 ton (ngarkesa)

Transport dhera m^3 $2376 \cdot 1.6 = 3802$ ton

Transport çakëll rere e zhavor stabilizant m^3 $3580 \cdot 1.8 = 6444$ ton

Transport material të ndryshme -50ton

Transport A/B + binder T- 1529 ton

Totali $11825:132=89.5$ ton:15=6, mesatarisht (6) rruge ne dite (2 mjete me nga 3 rruge)

2-Mjeti i transportit (kap mbajes)3-5 ton nevojitet per transportin e materialeve te ndertimit si cemento tuba material, elektrike etj

3-Betoniere nevojitet për përgatitjen e llaçeve dhe betoneve sipas zerave te preventivit.

4-Skreperi nevojitet per germim dheu sipas zerave te preventivit.

5-Grejderi nevojitet per nivelimin e shtresave te cakellit dhe stabilizantit, sipas zerave te preventivit.

6-Autoboti I ujit nevojitet per lagien me uje para ngjeshjes te shtreses se cakellit dhe stabilizantit sipas zerave te preventivit

7-Rrul per ngjeshje çakelli nevojitet për ngjeshjen e shtresës se cakellit dhe stabilizantit sipas zerave te preventivit.

8-Rrul per ngjeshje binderi dhe asfalti, nevojitet per ngjeshjen e shtreses se binderit dhe A/B sipas zerave te preventivit.

9-Autobitumatricja nevojitet per lagien me bitum te shtreses se stabilizantit dhe binderit sipas zerave te preventivit.

10-Asfaltoshtuesja nevojitet per hapjen ne rruge te shtreses se binderit dhe A/B. sipas zerave te preventivit.

11-Autovinci nevojitet per kryerjen e punimeve te ndertimit sipas zerave te preventivit

12-Matrapiku nevojitet per kryerjen e punimeve te prishjes sipas zerave te preventivit.

13-Minifadroma nevojitet per kryerjen e punimeve sipas zerave te preventivit dhe sipas projektit pasi është e nevojshme ne ate zone ku gjeresia e rruges nuk lejon te punohet me skreper.

14-Aubetoniera nevojitet per kryerjen e punimeve sipas zerave te preventivit.

15-Eskavatori me goma nevojitet per kryerjen e punimeve sipas zerave te preventivit.

16-Sperkates boje per vizime ne rruge(makineri ose paisje) nevojitet per kryerjen e punimeve te vizimit te rrugeve sipas zerave te preventivit.

2.3.10 Operatori/et ekonomik duhet të paraqesin certifikatat e cilësisë së punimeve, per objektin qe prokurohet, te cilat duhet te jene te perkthyer ne gjuhen shqipe dhe te noterizuara, sipas standardeve:

- Çertifikatën e menaxhimit të cilësisë **ISO 9001:2015** (e vlefshme) ose ekuivalente, e akredituar nga DPA ose nga Organizma Ndërkombëtarë Akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë. Në rastet e Bashkimit të Operatorëve ekonomik, çdo anëtar i grupit duhet të paraqesë Çertifikatën ISO 9001:2015 ose ekuivalente.

- Certifikatën e menaxhimit të mjedisit **ISO 14001-2015** (e vlefshme) ose ekuivalente, e akredituar nga DPA ose nga Organizma Ndërkombëtarë Akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë. Në rastet e Bashkimit të Operatorëve ekonomik, çdo anëtar i grupit duhet të paraqesë Certifikatën ISO 14001-2015 ose ekuivalente.
- Certifikatën e menaxhimit të sigurisë dhe shëndetit **ISO 45001-2018** ose certifikatën për standardin e përditësuar ISO 45001-2023, (e vlefshme) ose ekuivalente, e akredituar nga DPA ose nga Organizma Ndërkombëtarë Akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë. Në rastet e Bashkimit të Operatorëve ekonomik, çdo anëtar i grupit duhet të paraqesë Certifikatën ISO 45001-2018 ose certifikatën për standardin e përditësuar ISO 45001-2023 ose ekuivalente.

Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomikë, çdo anëtar i grupit duhet të paraqesë certifikatat e kërkuara të cilësisë sipas zërave që merr përsipër të realizojë në aktmarrëveshje.

Pranohet edhe paraqitja e standardeve shqiptare **SSH** mbi konformitetin e standardeve europiane dhe të lëshuara nga organizma të vlerësimit të konformitetit të akredituara në Republikën e Shqipërisë.

Argumentim: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 79, “Standardet e sigurimit të cilësisë dhe standardet e menaxhimit mjedisor” të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, dhe nenin 39, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Për vet natyrën e veçantë, vendndodhjes dhe përmasat e objektit të kontratës që do të prokurohet, është tepër e rëndësishme që operatorët si zbatues, të kryejnë veprimtarinë me standardet e kërkuara të cilësisë. Sistemi i menaxhimit të cilësië, mjedisit dhe shëndetit dhe sigurisë në punë janë standarte që çdo subjekt juridik apo privat e ka qëllim në arritjen e suksesit. Këto certifikata lidhen ngushtësisht me objektin e kontratës përse kohë do të pronohen edhe ekuivalentet e tyre dhe i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e kapaciteteve të operatorëve ekonomikë dhe të mundësisë së tyre për përmbushjen e plotë të kontratës. Referuar në nenin 79 të ligjit 162/2020, parashikohet se autoriteti kontraktor mund të kërkojë certifikata, të lëshuara nga organe të pavarura, që vërtetojnë pajtueshmërinë e kandidatit ose të ofertuesit me standardet e kërkuara të cilësisë, përfshirë edhe standardet për menaxhimin e mjedisit, shëndetit dhe sigurisë në punë.

ISO 9001:2015 ose ekuivalente, është një seri normash dhe standartizimesh ndërkombëtare, që i referohen sistemeve të menaxhimit të cilësisë, pra, të strukturave të organizimit të ndërrmarjeve publike dhe private, struktura të cilat këto ndërrmarje duhet t’i adoptojnë për një orientim më të mirë të ndërrmarjes në standartet e tregut. AK gjykon se çdo Ofertues duhet të jetë i pajisur me ISO 9001:2015 ose ekuivalente, me qëllim efektivitetin dhe efektshmërinë në zhvillimin e veprimtarisë së tij, e cila do të sjellë dhe zvogëlimin e kostove. Pra ky certifikim do të bëjë të mundur që Ofertuesit të ofrojnë cilësi të mirë me çmime të ulta.

ISO 14001:2015 ose ekuivalente, ofron një kuadër praktik për shoqëritë që duan të menaxhojnë rreziqet mjedisore ekzistuese dhe potenciale. Ky sistem integrohet lehtësisht në strukturën e menaxhimit të biznesit për të kontrolluar impaktet që aktivitetet, operacionet, produktet dhe shërbimet kanë mbi mjedisin. AK gjykon se çdo Ofertues duhet të jetë i pajisur me ISO 14001:2015 ose ekuivalente, me qëllim që veprimtaria e ushtruar nga ana tij (në rastin konkret realizimi i punës objekt prokurimi) të identifikojë impaktin në mjedis gjatë aktivitetit të saj si

dhe të përmirësojë performancën mjedisore duke zbatuar një qasje sistematike. Pra ky çertifikim do të bëjë të mundur që Ofertuesit të ushtrojnë veprimtarinë duke pasur në konsideratë parimin e mbrojtjes së mjedisit.

ISO 45001-2018 ose 45001-2023 ose ekuivalente, është standard ndërkombëtare, i cili parashtron kërkesat për menaxhimin e praktikave të mira të sigurisë dhe shëndetit në punë për çdo organizatë, pavarësisht nga madhësia. AK gjykon se çdo Ofertues duhet të jetë i pajisur me ISO 45001-2018 ose ekuivalente, me qëllim që veprimtaria e ushtruar nga ana tij (në rastin konkret realizimi i punës objekt prokurimi) të realizohet duke u mbështetur mbi parimin e sigurisë dhe shëndetit në punë. Kjo kërkesë shërben dhe si një garanci extra që do të sjellë reduktimin e aksidenteve dhe sëmundjeve në vendin e punës duke minimizuar kostot si dhe kohën në përmbushje me sukses të kontratës së punës objekt prokurimi.

AK gjykon se kërkesa për pajisjen e Ofertuesve me Çertifikatat e kërkuara sipas pikës 12 gërma “a”- “e”, është brenda kuadrit të parashikuar nga legjislacioni për prokurimin publik. Çertifikatat e kërkuara janë në përpjestim me objektin e kontratës dhe respektojnë natyrën e punimeve.

Operatorët e huaj duhet të bëjnë ekuivalentimin e licensave profesionale që disponojnë të lëshuara nga vendi i origjinës, pranë Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë, (ose Ministrisë kompetente të kohës) Republika e Shqipërisë. (Rregullorja për kriteret dhe procedurat e dhënies së licensave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike që ushtrojnë veprimtari ndërtimi, e miratuar me VKM- në, Nr.42, datë 16.01.2008). Mosparaqitja në këtë formë është kusht skualifikues.

Periudha e garancise per defektet është **2 vjet** pas marrjes ne dorëzim te objektit (hartimit te procesverbalit te marrjes ne dorezim dhe certifikatës)

Është vendosur ky kriter duke u bazuar në ligjin nr. 8402 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit” datë 10.09.1998, i ndryshuar pasi periudha e garancisë së punimeve referuar këtij ligji shkon nga 1 deri 2 vite.

Argumentimi i specifikimeve teknike

*Shënim: Përcaktoni specifikimet teknike, për punimet objekt prokurimi, të cilat duhet të shprehin qartë kërkesat e autoritetit/entit kontraktor për cilësinë e të gjitha punimeve dhe të materialeve që do të përdoren, si dhe kërkesa të tjera që lidhen ngushtë me natyrën dhe përbërësit e projektit të punës, në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të LPP, si dhe nenit 39, pika 2, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, **duke argumentuar çdo kërkesë funksionale ose performance, apo/dhe çdo standard të kërkuar**, ku çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët “ose ekuivalenti i tij/saj”.*

Kujdes: Në specifikimet teknike, nëse nuk e justifikon objekti i kontratës, nuk duhet të përmendet asnjë markë prodhimi ose burim specifik apo proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një operator ekonomik specifik apo asnjë markë tregtare, patentë, tipi ose origjinë apo prodhim specifik, me qëllim favorizimin ose eliminimin

e disa sipërmarrjeve ose produkteve. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste përjashtimore kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme e përshkrimit të objektit të kontratës, sipas pikës 3 të nenit 36, të LPP. Referime të tilla duhet të shoqërohen nga fjalët “ose ekuivalente”.

Sipas materialit bashkëngjitur DST.